



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 195/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lulzim Rustemit-Shef i Shtabit Zgjedhor të PDK-së dega në Lipjan, paraqitur kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), dega në Lipjan, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lulzim Rustemit - Shef i Shtabit Zgjedhor të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Lipjan, kështu që koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 5150 (pesëmijë e njëqind e pesëdhjetë) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 07.10.2013, Lulzim Rustemi, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 06.10.2013, në qendër të Lipjanit, në Sheshin “Adem Jashari” dhe në rrugën “Skënderbeu”, persona të pa njohur për ankusin nga radhët e koalicionit AAK - LDD kanë mbuluar posterat e kandidatit të PDK-së për kryetar komune z. Shukri Buja dhe kandidatëve për kryetar komune nga radhët e PDK-së, me posterat e kandidatit për kryetar komune nga radhët e koalicionit AAK - LDD të z.Fitim Selimi . Parashtruesi i ankesës pretendon se, me këtë veprim është shkelur neni 4 pika a e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët nr. 11/2013 . Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të merren masa urgjente në mënyrë që veprimet e tilla të mos përsëriten . Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur tri fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi koalicionin AAK - LDD, me datën 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013 deri në ora 18:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga koalicioni AAK-LDD, lidhur me ankesën Anr 195/2013, të paraqitur nga Lulzim Rustemi, ku theksohet se vendosja e posterit të kandidatit të koalicionit AAK - LDD në Lipjan mbi atë të kandidatit të PDK-së nuk është bërë nga strukturat e AAK-së, duke pretenduar se vendosja e posterëve mund të jetë bërë nga qytetarë apo individ të pa informuar . Më tutje ka shtuar se, kandidatët si ai nga radhët e PDK-së dhe kandidati i koalicionit AAK-LDD kanë qenë bashkëpunëtorë deri në kalimin e z.Fitim Selimi në radhët e koalicionit AAK-LDD dhe krejt kjo është një tendencë e strukturave të PDK-së me qëllim të manipulimit, sulmeve, shantazheve kundër kandidatit z. Selimi . Koalicioni AAK-LDD e ka konfirmuar se me të pranuar njoftimin për

dukjen e posterëve të kandidatit të tyre mbi posterin e kandidatit të PDK-së ka urdhëruar strukturat menaxhuese për të bërë largimin e këtyre posterëve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografitë të ofruar si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si posterat e koalicionit AAK-LDD janë të vendosur mbi posterat e subjektit politik PDK, gjë që e bën përgjegjës koalicionin AAK-LDD, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika a) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. që ndalon mbulimin e posterave nga një subjekt tjetër politik.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga koalicioni AAK-LDD, përveç thënieve se veprimet e tilla nuk janë bërë nga strukturat AAK-së me pretendim se vendosja e posterave mund të jetë bërë nga qytetarë apo individ të pa informuar. Në përgjigje të ankesës është bashkangjitur një udhëzim drejtuar: kryetarëve të degëve, kandidatëve për kryetar të komunave dhe shefave të shtabeve zgjedhore komunale për respektimin e rregullave zgjedhore mirëpo për rastin në fjalë nuk është ofruar asnjë dëshmi që kanë ndërmarr veprime për evitimin e shkeljes së supozuar siç kërkohet nga dispozitat e nenit 32.6 të LZP-së.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i konstatoi se koalicioni AAK-LDD, në këtë rast ka thyer Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) dhe 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrisa

Anr. 195/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*